



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SER. OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prenjane / Predato Received / Delivery	16.02.2021	1	viti god year
Organ / Agjencia Organ / Jednica Org. / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAMSHOK	689/2021		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.11/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Dem- kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Çlirim Zeka Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.11/2021 të datës 11.01.2021, të parashtruar nga me adresë banimi Rr. "Uglarit" Linda 3/5, Fushë Kosovë, kundër organit të punësimit Komuna e Drenasit, në çështjen juridike " Masë Disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 15.02.2021, mori këtë;

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.11/2021 e datës 11.01.2021, e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi masa disiplinore "Vërejtje me shkrim" me numër protokollit 02 Nr.116/01-53530 e datës 09.12.2020.

A r s y e t i m

në pozitën e Zyrtares së Gjendjes Civile në Komunën e Drenasit, me datë 11.01.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 64/2021 të regjistruar me A.nr.11/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër masës disiplinore " Vërejtje me shkrim" të datës 09.12.2020, të shqiptuar ndaj ankueses nga Udhëheqësja e Zyrës së Gjendjes Civile, në Komunën e Drenasit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 15.01.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Drenasit, ndërsa Këshilli me datën 26.01.2021 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Drenasit, së bashku me shkresat e lëndës nga fq.1/24.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër A.nr.11/2021, e datës 11.01.2021, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 15.01.2021; Njoftimin e datës 06.01.2021; Vërejtje me shkrim e datës

09.12.2020; Aktvendimin e datës 23.10.2019; E-mailin e datës 03.12.2020; E-mailin e datës 04.12.2020; E-mailin e datës 07.12.2020; Ankesën drejtuar Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave në Komunën e Drenasit te datës 24.12.2020; Vendimin e Qeverisë se Kosovës për masat e përgjithshme dhe specifike për mbrojtëse nga pandemia Covid-19 te datës 11.11.2020; Njoftimin për mbyllje të përkohshme të Çerdhes Publike në Fushë Kosovë të datës 02.12.2020; E-mailin e datës 11.01.2021; Përgjigjen në ankesë të datës 26.01.2021; Akt Emërimit të datës 23.05.2014; Formularin e Përshkrimit të detyrave të punës të Vitit 2012 të datës 21.02.2014; E-mailin e datës 03.12.2020; E-mailin e datës 07.12.2020; E-mailin e datës 04.12.2020; Raportin i prezencës në punë për periudhën 01.01.2020 deri 31.12.2020; Pliko e datës 22.01.2021;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas konstatimit se janë plotësuar kushtet ligjore për pranueshmerinë e ankesës si dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses . *është e pa bazuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës respektivisht sipas Akt Emërimit me numër protokollit 01-120-21470 te datës 23.05.2014, Kolegji ka konstatuar se ankuesja mbanë pozitën e Zyrtares se Gjendjes Civile, në Zyrën e Gjendjes Civile, në Komunën e Drenasit.

Udhëheqësja e Zyrës së Gjendjes Civile në Komunën e Drenasit, në cilësinë e mbikëqyrëses se drejtpërdrejtë, me datë 19.12.2020 ankueses i ka shqiptuar masën disiplinore "Vërejtje me shkrim", për shkak se e njëjta pa aprovimin e saj nuk është paraqitur në punë nga data 03.12.2020 deri 09.12.2020, për çka ka bërë shkelje disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kundër masës disiplinore "Vërejtje me shkrim" të datës 09.12.2020, ankuesja me datë 24.12.2020 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Disiplinë dhe Ankesa të Zyrtarëve Publikë në Komunën e Drenasit. Komisioni për Disiplinë dhe Ankesa të Zyrtarëve Publikë me datë 06.01.2021 ka njoftuar ankuesen se bazuar në Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë nuk është kompetent për shqyrtimin e ankesës te parashtruar nga ankuesja, dhe e ka udhëzuar palën lidhur me te drejtën e parashtrimit të ankesës drejtpërdrejt në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës.

Ankuesja me datë 11.01.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se masa disiplinore është e pa drejtë dhe në kundërshtim me Vendimin e Qeverisë se Kosovës Nr.01/48 te datës 11.11.2020 për shkakun se ankuesja është vetushqyese e fëmijëve.

Bazuar në shkresat e lëndës Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se ankuesja me datë 03.12.2020 i është drejtuar me kërkesë Drejtores se Departamentit të Përgjithshëm si dhe Udhëheqëses se saj, që të punoj nga shtëpia sepse kopshti i fëmijëve ku ajo ka djalin është mbyllur. Po në të njëjtën ditë Drejtoresha e Departamenti të Përgjithshme ka njoftuar ankuesen se ajo nuk mund të punoj nga shtëpia sepse shumica e akteve që lëshohen nga Zyra e Gjendjes Civile duhet të nënshkruhen nga palët me rastin e lëshimit dhe se kemi pasur mirëkuptimin ndaj jush duke ju lenë të lirë për përkujdesje të fëmijëve.

Sipas Raportit të prezencës në punë për periudhën nga data 01.01.2020 deri 31.12.2020, si dhe shkresave tjera të lëndës, Kolegji ka konstatuar se ankuesja nuk ka qenë në punë për periudhën nga data 03.12.2020 deri 09.12.2020, dhe po ashtu Kolegji ka gjetur se gjatë vitit 2020 ankuesja nuk ka vijueshmëri të rregullt në punë për shkak të situatës së pandemisë dhe mundësisë që i është dhënë nga organi i punësimit për përkujdesje të fëmijës, fakt ky i pohuar edhe nga Drejtoresha e



Departamentit te Përgjithshëm në e-mailin e datës 03.12.2020 si dhe nga vet Udhëheqësja e ankueses në shkresën e datës 09.12.2020.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave lidhur me pretendimet ankimore ka analizuar edhe Aktvendimin nr.01Nr.070/01-61741 të datës 23.10.2019 të Komunës së Drenasit sipas të cilit ankueses i është miratuar drejta e gjydhënies nga data 22.10.2019 deri 04.01.2021 si dhe Vendimin e Qeverisë së Kosovës Nr.01/48 të datës 11.11.2020 për masat e përgjithshme dhe të veçanta për mbrojtje nga pandemia COVID-19, përkatësisht pikën 8 të këtij vendimi i cili ka përcaktuar se: *personat me sëmundje kronike, gratë shtatzëna dhe gratë gjydhënëse janë të liruara nga puna, ndërkaq punëdhënësit udhëzohen, që për aq sa është e mundshme, të krijojnë kushte për angazhimin e tyre në punë nga shtëpia.* Në këtë kuptim, si dhe duke pas parasysh natyrën e punës të cilën e kryen ankuesja siç janë regjistrimi i lindjeve, vdekjeve dhe martesës në Regjistrin Civil, kryeja e ceremonisë martesore, lëshimi i certifikatave të gjendjes civile etj. Kolegji e vlerësoj si të drejtë konstatimin e organit të punësimit se në rastin e ankueses puna nga shtëpia ka qenë e pamundur. Ndërsa e drejta e gjydhënies e njohur me Aktvendimin Nr.01Nr.070/01-61741 të datës 23.10.2019, është dashur të shfrytëzohet nga ankuesja ashtu siç është e përcaktuar me këtë vendim.

Andaj, bazuar në faktet si me lartë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se Udhëheqësja e ankueses ka vepruar drejtë me rastin e përcaktimit të përgjegjësisë disiplinore të ankueses e cila pa lejen dhe pa aprovimin e Udhëheqëses ka munguar në punë nga data 03.12.2020 deri 09.12.2020, po ashtu në mënyrë të drejtë ka cilësuar veprimet e ankueses si shkelje të lehta disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrat e Publikë. Mbi këtë bazë rrjedh se pretendimet ankimore të ankueses janë të pa bazuara.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A. nr. 11/2021

Çlirim Zeka

Çlirim Zeka
Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses;
- Kryetarit të Komunës së Drenasit
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Drenasit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

